

E MERKURA E MADHE

SHERBESA E DHENTERRIT III

*Kjo Shërbesë bëhet të Martën e Madhe mbrëmëane.  
Këndimet vazhdojnë si në Shërbesën e Dhëntërrit I gjer në  
fundin e Troparit të Dhëntërrit. Pastaj:*

## NDENJESORET

## PAS TIN OREOTITA, T. III.

T' ardhni lavira sot, myrra dhe lote derth, këmbët t'i lan me mall, o Perëndi dhe Zot, dhe nga mëkatat e çpërblen mëshir' e Njeridashësit; nxënës' i argjënëve, që të mirën s' e njihte dot, hirin tënt e hodhi tej, dhe në lllom' u-përmbys me turp, edhe të shiti nga argjëndashja, Krisht Perëndi mëshirë kij për ne.

LAVDI DHE TANI. *Gjithajo.*

## PAS TAKHI PROKATALLAVE, T. IV.

Dinaku i shtrëmbëri, nga argjëndashja u-mbyt, dhe Zotin e tradhëton, për jetë veten e dënon, përandaj si i dehur, rent përpara Judenjve, dhe u thot' i pabesi: Sa argjënëve më jipni, tjuja dorëzonj për dënim, për kryqësim dhe varrim.

LAVDI DHE TANI. *Gjithajo.*

## PAS TON TAFON SU SOTIR, T. I.

Lavira me vajtim, o i dhëmpshur të lutej, dhe këmbët besërisht, po t'i fshinte me flokët, dhe thellazi po psherëtin, dhe thërriste me lot në sy: Mos më neverit, mos më përbuz o i mirë, prit-më se të vinj, plot me pendim dhe shpëto-më, o Zot i mëshirave.

LAVDI DHE TANI. *Gjithajo.*

*Pastaj Prifti këndon Ungjillin:*

## UNgjILLI PAS JOANIT

Më atë kohë, gjindja, që e kishin parë, dëshmonin që Jesuj e thirri Lazarin nga varri, dhe e ngjalli së

vdekurësh, dhe përandaj populli, kur dëgjuan që kishte bërë atë çudi, i duallnë përpara që ta prisnin. Farisianët, pra, thanë me njerjatrën: "A e shikoni që nukë kini nonjë fuqi? Se ja, bota i venë pas përsëri". Edhe midis atyre, që ishin ngjitur të falëshin për të kremten, ishin disa Helinë; edhe këta i vanë Filipit prej Bethsaidës së Galilesë, dhe i lutëshin, dyke thënë: "Zot, duam ta shohim Jesunë." Edhe Filipi i tha Andreut; edhe Andreu bashkë me Filipin i thanë Jesujt. Edhe Jesuj u-përgjeq, edhe u tha: "Ardhi ora që të lavdërohet i Biri i njeriut. Me të vërtetë, me të vërtetë po ju them: Po të mos bjerë koqja e grurit mi dhenë dhe të mos varroset, mbetet e vetëm; po, pasi të varroset, mbin dhe sjell shumë pemë. Ay, që e do jetën e vetë, do ta humbasë; po ay, që e urren jetën e vetë në këtë botë, do ta shpëtonjë për jetën e ameshuar. Ay, që më shërben, le të më bjerë pas; edhe atje, ku jam unë, do të jetë edhe shërbëtori im; edhe im-Atë do ta nderonjë atë, që më shërben. Tani më është përzier shpirti. Edhe qysh munt të them, 'Atë, shpëto-më nga kjo orë?' Po për këtë shkak kam ardhur në këtë orë. Atë, lavdëroje emrin tënt."

Ahere ardhni një zë nga qjelli: "Edhe e kam lavdëruar, edhe përsëri do ta lavdëronj." Gjindja, pra, që ishin atje dhe e dëgjuan, thanë se u-bë bumbullimë. Të tjerë thoshin se i foli një Engjëll. Edhe Jesuj u tha: "Ky zë nuk u-bë për mua po për ju. Tani po bëhet gjyqi i kësaj bote. Tani princi i kësaj bote do të hidhet jashtë. Edhe unë, po të fluturonj prej kësaj bote, do t'i heq të gjithë njerëzit pas." Edhe këtë e tha për të treguar me ç' farë vdekje kishte për të vdekur. Edhe gjindja i thanë: "Ne kemi dëgjuar nga ligja se Krishti mbetet për jetë; dhe qysh na thua ti që i Biri i njeriut

do të fluturonjë prej kësaj bote?” Edhe Jesuj u-përgjeq: “Edhe pak kohë e kini dritën, ecëni sa e kini dritën, që të mos ju zërë errësira; dhe ay, që baret në errësirë, nukë di se se ku vete. Sa kohë e kini dritën, besojeni dritën, që të bëheni bij të ditës.”

Passi u tha këto fjalë, Jesuj shkoj, edhe u-fsheh prej atyre. Dhe ndonëse kishte bërë aqë çudira përpara atyre, prapë nuk e besonin, që të mbushet fjala e Profetit Isaia, i cili thotë. “Zot, kush e besoj lajmën tonë? Edhe kujt i është zbuluar krahu i Zotit?” Përandaj nukë muntnin ta besonin, se Isaia prapë tha: “Ua verboj sytë dhe ua ashpëroj zëmrat, që të mos shikojnë me sytë, dhe të mos kuptojnë me zëmren, edhe të mos kthehen, edhe t’i shëronj.” Këto gjëra i tha Isaia, kur e pa lavdinë e tij, edhe foli për atë. Me gjithë këto, edhe shumë veta prej krerëve e besuan; po nga shkaku i Farisianëve nuk e rrëfenin, që të mos nxirëshin jashtë sinagojës; se deshnë më tepër lavdinë e njerësve se sa lavdinë e Perëndisë.

Edhe Jesuj thirri, dhe tha: “Ay, që më beson, nukë më beson mua, po beson atë, që më ka dërguar. Edhe ay, që më shikon mua, shikon atë, që më ka dërguar. Kam ardhur si një dritë në botë që të mos mbeten në errësirë ata, që më besojnë. Edhe nukë e gjykonj atë, që i dëgjon fjalët mia, dhe nukë beson; se nukë kam ardhur të gjykonj botën, po ta shpëtonj. Ka se kush ta gjykonjë atë, që më heth poshtë, dhe nuk i pret fjalët e mia; fjala, që kam folur, do ta gjykonjë më ditën e funtme; se unë nukë kam folur prej vetes sime; po Ati, që më ka dërguar, ay më porrositi se ç’ të them, edhe ç’ të flas. Edhe di që porrosia e tij është jeta e ameshuar; ato, pra, që ju fjas i flas ashtu, sikunder më ka thënë Ati.”

KORI: Lavdi më ty, o Zot, lavdi më ty.

*Pastaj Psallmi 51 pa zë, dhe Litania e Vogël:*

DHJAKU: Përsëri dhe përsëri. . . . .

PPRIFTI: Se ti je Mbreti i Paqes dhe Shpëtimtari i shpirteve tona, dhe ty të dërgojmë lavdi, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shentjë, tani dhe përherë, dhe në jetët e jetëve.

SHKURTORJA, T. IV.

PAS O IPSOTHIS EN TO STAVRO

Unë që shkela ligjat më keq se lavira, nukë të prura shira lotesh asfare, po dyke heshtur lutem dhe të bie më gju, këmbët po t’i përshëndosh, me pendim edhe plot me mall, fal-më çdo mëkat dhe faj, si i mir’ e i dhëmpshur, se të thërres me zë o Shpëtimtar: Nxir-më nga lloma, o Zot i mëshirave.

SHTEPIA

Gruaja ish-prodige u-tregua befas e urtë, kujtoj dënimin e Ferrit, edhe hoqi dorë nga mëkatat, edhe rendi dhe i thirri Shpëtimtarit. Nxir-më nga lloma, o Zot i mëshirave.

SINAKSARI

Të Mërkurën e Madhe të Shentjë, kujtojmë Gruan Mëkatare, që e lyejti Zotin me myrrë.

O Krisht o Përëndi, që jje lyer me myrrën mëndore, çlirona nga pasionet e ashpëra, dhe mëshirona, si i vetëm i shenjtë dhe njeridashës.

*Pastaj Dhjaku thotë:*

DHJAKU: Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës me hymne nderimi le ta madhështojmë.

*Vallet këndojnë Këngën IX të Kanunit. Priti temjanis.*

### KENGA IX

T. II. Me zëmr' e me shpirt, dhe me buzë ëngjëlli, eni madhështojeni të pacinuarën, Virgjërshën dhe Nënëen e Zotit Jesu; me atë dhe prej asaj, kërkujmë nërmjetime të nxehta: Shpirtet ti kursenaji, dhe ti na shpëto, o Krisht Perëndi.

Të mirën s' e njeh, dhe ka nakar dhe ka zili, hirin dhe dhuratën e qjellit e heth, dhe bën marrëveshje për të shitur vetë Jesunë, tregëtari burracak, dhe i pabesë Juda i prapë: Shpirtet ti kursenaji, dhe ti na shpëto, o Krisht Perëndi.

Vatji dhe u tha, Kryepriftinjtve Shkronjësve: Sa më jipni si çpagim, dhe unë Zotin Krisht, jetëdhënësin, në duartë jua shtie; edhe Juda për një çmim, e shiti Shpëtimtarin poshtërisht. Shpirtet ti kursenaji, dhe ti na shpëto, o Krisht Perëndi.

### ZBRITERSORJA IX

Me zëmr' e me shpirt, dhe me buzë ëngjëlli, eni madhështojeni të pacinuarën, Virgjërshën dhe Nënëen e Zotit Jesu; me atë dhe prej asaj, kërkujmë nërmjetime të nxehta: Shpirtet ti kursenaji, dhe ti na shpëto, o Krisht Perëndi.

*Pastaj Dhjaku thotë Litaninë e Vogel:*

DHJAKU: Përsëri dhe përsëri, më paqe le t'i lutemi Zotit. . . . .

PRIFTI. Se ty të këndojnë gjithë Forcat e qjellit, edhe ty të dërgojmë lavdi, Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë. . . . .

### DERGIMESORJA, T. III

Nusëroren tënde shoh, o Shpëtimtar të stolisur, edhe robë nukë kam, edhe s' kuxonj të hynj n' atë; ndriço-ma pra stolin' o Zot, dhe prit-më dhe shpëto-më, midis të gëzuarve. (3 herë)

### LAVDERIMET, T. I.

Gruaja mëkatore të njohu, o i Bir' i Virgjërshës, dhe e penduar të lutej me lote: Shpëto-më dhe do të leçit nëpër publikanët, o mirëbërës njeridashës.

Myrrën e çëmuar e trazoj me lote, dhe ta derdhi mi këmbët, edhe ti e fale menjëherë; falna edhe ne o Zot, që pësove për ne dhe shpëtona.

Kur mëkatarja të blatonte myrrën, dishepulli merrej vesh me të paudhët. Ajo e njohu Zotin, edhe ky ndahej prej Zotit; ajo çlirohej prej mëkatave, edhe ky bëhej rob i armikut. Sa i tmerruar është plogërimi! Sa i bukur është pendimi! Këtë dhuro-ma o Shpëtimtar, që pësove për ne dhe shpëto-më.

O poshtërsi e Judës! E shikonte mëkatoren, që i përshëndoshte këmbët Jesujt, edhe ay mejtohej se qysh ta tradhëntonte. O poshtërsi e Judës! Nga kjo shpëtoji shpirtet tona, dhe falna pendimin o Perëndi.

LAVDI, T. II. Mëkatarja të blente myrrën e vyer, që ta miroste mirëbërësin, dhe i thërriste myrrëtarit: Nema myrrën që ta lyenj atë, që m'i shpërlau të gjitha mëkatat.

TANI. E. mbytura në mëkata, të gjeti si liman shpëtimi, dhe dyke derdhur myrra dhe lote të thërriste: Shpëto-më nga shqota e mëkatave, pas mëshirës sate së mahe o Zot.

*Doksollogjia e Madhe pa zë, dhe Litania e Gjatë.*

### PASVARGJET, T. T. II

Sot Krishti vajti në shtëpinë e një Farisiani, dhe i ardhni një grua mëkatore, dhe i ra nër këmbë dhe i thërriste: Kij mëshirë për mua të mjerën, dhe fal-mi mëkatat edhe shpëto-më.

Mëkatarja ia zgjati duartë Shpëtimtarit; Juda ua zgjati dorën të paudhëve; ajo për të marrë ndjesë; ky për të marrë argjënde. O Zot që u-shite dhe na çlirove, lavdi më ty.

Gruaja e lloës, e shtrirë në këmbët e Jesujt, i lutet e përlotur: Ngjall-më mua të vdekurën, siç e ngrite Lazarin nga varri pas katër ditësh, dhe shpëto-më o Zot.

E dëshpëruara nga jeta, dhe e penduara me shpresë, me myrra dhe me lote, i thërriste Krishtit: Prit-më të penduar, o gëzim i Engjëjve, o Zot mëshirëplot.

### LAVDI DHE TANI, T. T. IV.

#### TROPARI I MURGESHES KASIANA

Zoti Krisht, ajo që ra në mëkata të shumta ty po të vjen, të mori vesh që je Perëndi dhe Zot, dhe t' afrohet me myrra dhe me lote, dhe me vajtime dhe me zi, për vdekjen tënde dhe varrimin. Mjera unë tha, se në shpirtin kam natën, zeglën e pasionit, të errët dhe të pahënëshme, dashurin' e mëkatit. Prit-m'i lotet që

derdhen si lumë, ti që lart e heq në retë tërë ujën e detit; unju dhe dëgjo-m'i psherëtimet e zëmrës, se zbritë edhe qjellin me mëshirën e pamatur. Ja ku t'i putha edhe duart' edhe këmbët, ja ku t'i fshiva dhe t'i spastrova, me gërshetet dhe me flokët e kokës; mbrëmane në Parajsë Eva kur u dëgjoj, krismën trokëllimën këtyre, u-fsheh e tmerruar. Fajet e mia të shumta, dhe mëkatat dhe greminat, kush m'i nëmëron o Shpëtimtar jetëdhënës? Mos më përbuz mua të mjerën, o i vetëmi Zot i mëshirave.

*Pastaj vazhdon dhe mbaron si Shërbesa e Dhëntërrit I.*

### MESHA E PARESHENJTERUAR

*Të Mërkurën e Madhe në mëngjes bëhet Mesha e Parëshenj-tëruar sipas Uratores, f. 149-178, gjer në Thirrtoret:*

Gruaja mëkatore të njohu, o i Bir' i Virgjëreshës, dhe e penduar të lutej me lote: Shpëto-më dhe do të lëçit nëpër publikanët, o mirëbërës njeridashës.

Myrrën e çëmuar e trazoj me lote, dhe ta derdhi mi këmbët, edhe ti e fale menjëherë; falna edhe ne o Zot, që pësove për ne dhe shpëtona.

Kur mëkatarja të blatonte myrrën, dishepulli merrej vesh me të paudhët. Ajo e njohu Zotin, edhe ky ndahej prej Zotit; ajo çlirohej prej mëkatave, edhe ky bëhej rob i armikut. Sa i tmerruar është plogërimi! So i bukur është pendimi! Këtë dhuro-ma o Shpëtimtar, që pësove për ne dhe shpëto-më.

O poshtërsi e Judës! E shikonte mëkatoren, që i përshëndoshte këmbët Jesujt, edhe ay mejtohej se qysh ta tradhetonte. O poshtërsi e Judës! Nga kjo shpëtoji sapirtet tona, dhe falna pendimin o Perëndi.

T. II. Mëkatarja të blente myrrën e vyer, që ta miroste mirëbërësin, dhe i thërriste myrrëtarit: Nema myrrën që ta lyenj atë, që m'i shpër'lau të gjitha mëkatat.

T.T. II. E mbytura në mëkata, të gjeti si liman shpëtimi, dhe dyke derdhur myrra dhe lote te thërriste: Shpëto-më nga shqota e mëkatave, pas mëshirës sate së madhe o Zot.

Sot Krishti vatji në shtëpinë e një Farisiani, dhe i ardhni një grua mëkatore, dhe i ra nër këmbë dhe i thërriste: Kij mëshirë për mua të mjerën, dhe fal-m'i mëkatat edhe shpëto-më.

Mëkatarja ia zgjati duartë Shpëtimtarit; Juda ua zgati dorën të paudhëve; ajo për të marrë ndjesë; ky për të marrë argjënde. O Zot që u-shite dhe na çlirove, lavdi me ty.

Gruaja e llomës, e shtrirë në këmbët e Jesujt, i lutet e përplotur: Ngjall-më mua të vdekurën, siç e ngrite Lazarin nga varri pas katër ditësh, dhe shpëto-më o Zot.

E dëshpëruara nga jeta, dhe e penduara me shpresë, me myrra dhe me lote, i thërriste Krishtit: Prit-më të penduar, o gëzim i Engjëjve, o Zot mëshirëplot.

#### LAVDI DHE TANI, T. T. IV

#### TROPARI I MURGESHES KASIANA

Zoti Krisht, ajo që ra në mëkata të shumta ty po të vjen, të mori vesh që je Perëndi dhe Zot, dhe t' afrohet me myrra dhe me lote, dhe me vajtime dhe me zi, si për vdekjen tënde dhe varrimin. Mjera unë tha, se në

shpirtin kam natën, zeglën e pasionit, të errët dhe të pahënëshme, dashurin' e mëkatit. Prit-m'i lotet që derdhen si lumë, ti që lart e heq në retë tërë ujën e detit; unju dhe dëgjo-m' i psherëtimet e zëmrës, se zbritë edhe qjellin me mëshirën e pamatur. Ja ku t'i putha edhe duart' edhe këmbët, ja ku t'i fshiva dhe t'i spastrova, me gërshetet dhe me flokët e kokës; mbrëmane në Parajsë Eva kur u dëgjoj, krismën trokëllimën këtyrë, u-fsheh e tmerruar. Fajet e mia të shumta, dhe mëkatat dhe greminat, kush m'i nëmëron o Shpëtimtar jetëdhënës? Mos më përbuz mua të mjerën, o i vetëmi Zot i mëshirave.

*Pastaj bëhet Hyrja me Ungjillin:*

DHJAKU: Urtësi, o të drejtë!

KORI. Dritë gazmore . . . . .

*Pas Parëvargut edhe këndimeve nga Dhjata e Vjetër:*

DHJAKU: Urdhëro, o Atë.

PRIFTI: Urtësi, o të drejtë! Drita e Krishtit u n-drit të gjithëve.

*Pastaj këndon një herë, dhe Kori dy herë:*

#### KATEFTHINTHITO, T. I

Le të drejtohet posi temjani, lutja ime sot, përpara teje; duart' i ngre përpjetë, për mbrëmë si për kurban. (3 herë)

#### UNGJILLI PAS MATTHEUT

Kur ishte Jesuj në Bethani, në shtëpinë e Simon Leprozit, i ardhni një grua me një allabastër prej myrrë shumë të shtrenjtë, dhe ia derdhi mi kokë, kur ishte

shtruar në mësallën. Dhe kur e panë, dishepujtë u zëmeruan, dhe thanë: “Përse kjo humbje? Se kjo myrrë munt të shitej për një sumë të lartë, e cila t’u përndahej të varfërve.” Dhe Jesuj, kur e mori vesh, u tha: Përse e mërzitni gruan? So ajo më bëri një shërbim të mirë. Se të varfërit i kini kurdoherë me vete, po mua nukë më kini gjithënjë. Pastaj ajo ma derdhi myrrën mi trupin për varrimin tim. Me të vërtetë po ju them, kudo në botë që do të leçitet ky Ungjill, do të kujtohet edhe vepra e kësaj gruaje.” Ahere një prej të dymbëdhjetëve, i cili quhej Juda Iskarioti, u vajti Kryepriftinjve, dhe u tha: Ç’ më jipni që t’jua dorëzonj?” Edhe ata i dhanë tridhjetë argjënde. Dhe që ahere kërkonte rast që ta tradhëtonte.

*Pastaj vazhdon Mesha e Parëshenjtëruar, sipas Uratores.*